



Datë: 29.05.2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1942/2025, të datës 25.11.2025, të parashtruar nga ankuesi E.H, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe në mbështetje të nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më datë 29.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.1942/2025, e datës 25.11.2025, e parashtruar nga ankuesi E.H.
- II. Mbetet në fuqi** Vendimi Nr.Ref.995/2026 i datës 03.10.2025, i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, E.H. (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi*), më datë 25.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.Ref.995/2026 të datës 03.10.2025, të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me refuzimin e aplikacionit në procedurën e pranimin me Nr.ref:RN00018442, të shpallur më datë 19.08.2025 nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për pozitën e punës Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa kjo e fundit, më ka dorëzuar përgjigjet në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokoll 7557/2025, të datës 25.11.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për parashtrimin e ankesës e datës 25.11.2025; Kopja e Letërnjoftimit të ankuesit E.H; Vendimin e datës 03.10.2025 me Nr.Ref.995/2025; Opinion i Avokatit të Popullit në lidhje me Çështjen e interpretimit të “përvojës së punës” në kontekstin e konkurseve për punësim në institucione publike me Nr.207/2018 të datës 31.01.2018; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 03.12.2025; Përgjigje në Ankesë më datë 12.12.2025; Njoftim për kandidatët fitues me Nr.Prot:3972 të datës 31.10.2025; Njoftim me Nr.Ref.1118/2025 të datës 03.10.2025; Njoftim për kandidatët fitues të datës 20.10.2025; Konkursi me numër reference RN00018442, për pozitën Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm, ku afati për aplikim ka qenë nga data 20.08.2025-18.09.2025; Lista e aplikantëve; Vendimin e datës 08.10.2025 me Nr.Prot:3676 ; Akt emërimi i H.K me Nr.Prot:1285 të datës 03.04.2025; Akt emërimi i L.V me Nr.Prot:5583 të datës 22.10.2024; Akt emërimi i K.A-O me Nr.Prot:6232 të datës 26.11.2024; Aplikacioni i ankuesit E.H; Kontratë Pune në periudhë të caktuar kohore me Nr.prot:286/2025 të datës 04.08.2025; Letër Reference e lëshuar nga organizata QIKA-Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion e datës 13.01.2025; Letër Reference nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e datës 17.09.2025; Pasqyra e Trustit për periudhën kohore 16.03.2023-17.09.2025; Kontratë për punë praktike me Nr.Prot:2066 të datës 03.06.2025; Contract For Felloëship -Youth Initiative For Human Rights; Kontratë për punë praktike me Nr.Prot:6020 të datës 12.11.2024; Vërtetimin e datës 24.03.2025 me numër reference 978; Diplomë me numër 8576 dhe mori titullin Baçellor i Shkencave Politike-në Fakultetin Filozofik në Prishtinë; Formularët e vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë; Vendim për miratimin e përshkrimit të detyrave të punës me Nr.Prot:1083 të datës 10.07.2023; Formulari i përshkrimit të punës; Akt emërimi i F.F me numër protokoll 900/2024 të datës 01.07.2024; Akt emërimi i M.T me numër protokoll 5369 të datës 10.10.2024; Testet individuale për secilin kandidatë.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit, *është e pabazuar, sepse:*

Gjendja e fakteve

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se:

- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 19.08.2025, ka shpallur konkursin me Nr. ref: RN00018442, Grupi i Shërbimit të Jashtëm, pozita Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm, pesëmbëdhjetë (15) vende pune, më klasë Profesional 2 dhe më afat të aplikimi nga data 20.08.2025 deri më 18.09.2025.

- Në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 241 kandidatë, ku prej tyre edhe ankuesi, mirëpo, të njëjtit më Vendimin Nr.Ref.995/2026 të datës 03.10.2025, të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, i është refuzuar aplikimi mbi arsyen që ankuesi nuk ka plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, gjegjësisht, ankuesi nuk posedon kopjet e dëshmisë punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit lidhur më përvojën e punës që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë.

Pretendimet ankimore

Ankuesi pas publikimit të njoftimit përfundimtar të vlerësimit brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar ligjshmërinë e Vendimit Nr.Ref.995/2026 të datës 03.10.2025, të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me refuzimin e aplikacionit në procedurën e pranimit sipas konkursit me Nr.ref:RN00018442. Pretendon se ankuesi i plotëson të gjitha kriteret e këtij konkursi, përfshirë këtu edhe përvojën e punës së kërkuar prej 12 muaj. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar, të konstatoj së vendimi Ref. nr.995 është nxjerrë në kundërshtim të hapur me ligjin dhe opinionin e Avokati të Popullit, të anuloj vendimin Ref. nr.995 mbi refuzimin e aplikacionit si dhe të kthej konkursin në pikën fillestare.

Vlerësimi i Kolegjit

Duke u bazuar në nenin 5, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se *1.Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe sprovues të Kosovës; 1.2. anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm.... 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkëlqeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin. 3. Ne rast të rregullimit me ligj të veçantë, për shërbyesin civil me status të veçantë - dispozita mbizotëruese janë dispozitat e ligjit të veçantë...”, Kolegji i Këshillit konstaton së nëpunësit e shërbimit të jashtëm kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht marrëdhënia e punës dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës i nënshtrohet rregullimit ligjor sipas ligjit bazik për zyrtarët publikë dhe ligjeve të veçanta lidhur me fushat e specifikuar sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij ligji. Në këtë kontekst rrjedhë se procedura e kontestuar është shpallur dhe zhvilluar sipas Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.*

Kolegji i Këshillit shqyrtoi fillimisht aktin e shpalljes së konkursit publik me numër reference RN00018442, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se sipas pikës 3 dhe 7 të konkursit si kërkesa të përgjithshme formale dhe specifike në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: Arsimimi i kërkuar: *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në fushat: Shkenca Politike, Juridik, Marrëdhënie ndërkombëtare, Politikat e sigurisë, Studime Evropiane, Ekonomi, Diplomaci (ekonomike, publike dhe kulturore), Administratë Publike: Përvoja e punës e kërkuar: Së paku një (1) vit përvojë pune profesionale., ndërsa, si kriteret specifike janë përcaktuar: njohja e gjuhës angleze, gjermane, frënge, italiane, greke, spanjolle në Nivelin C1 apo C2 (e obliguar.). Gjegjësisht, sipas pikës 5 të konkursit si dokumente/dëshmi që kandidatet duhet të dorëzojnë më rastin e aplikimi janë vendosur: *Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës. ° Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në**

momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; ° Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër; dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës. ° Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit. ° Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion. ° Dokumente që dëshmojnë njohjen e gjuhës angleze, gjermane, frenge, italiane, greke, spanjolle në nivelin C1 apo C2. Njohja e gjuhës dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime universitare të kryera në këtë gjuhë.

Në kuptim të themelësisë së pretendimeve ankimore Kolegji i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 dhe 39 ku përcaktohet se: **Neni 9.1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë:** 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj'' dhe **Neni 39:** 1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi.

Po ashtu, për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me këtë çështje juridike-administrative Kolegji mori parasysh edhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me theks të veçantë nenin 6, paragrafi 2: 2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendimit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Referuar kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar nga ankuesi më rastin e aplikimit (i dorëzuar nga organi i punësimit me përgjigjen në ankesë), nga është vërtetuar se i njëjti posedon Diplomën numër 8576, të datës 17.09.2024, për përfundimin e studimeve themelore universitare më datë 12.09.2024, në Fakultetin Filozofik, Departamenti i Shkencave Politike, Universiteti "Hasan Prishtina". Lidhur me përvojën profesionale pas diplomimit ka ofruar si dëshmi Kontratën

nr.286/20025 të datës 04.08.2025 për themelimin e marrëdhënies së punës në KQZ-në në kohëzgjatje nga data 04.08.2025 deri më 31.12.2025(15 ditë deri në ditën e shpalljes së konkursit); Letër Referencën(pa datë dhe numër protokoll) të lëshuar nga Udhëheqësi i Divizionit për Planifikim dhe Koordinim të Politikave pranë MPJD-së, e më të cilin konfirmohet së ankuesi ka përfunduar stazhin profesional në Ministrinë e Punëve të Jashtme në kohëzgjatje prej 01.10.2024 deri 01.08.2025, si dhe kontratën për punë praktike nr.prot: 2066 të datës 03.06.2025, më MPJD-në për periudhën kohore 15.04.2025 deri më datë 15.10.2025. Ndërsa, lidhur me kriterin e njohjes së gjuhës së huaj siç përcaktohet më konkurs, ankuesi zotëron Certifikatën e datës 10.09.2024, të lëshuar nga kompania C.A.Y për përfundimin e nivelit C1 të gjuhës angleze. Pra, mbi gjendjen e këtyre fakteve rrjedhë së ankuesi nuk ka gjithsej 1 vit përvojë punë pas diplomimit, pasi që, i njëjti ka diplomuar më datë 12.09.2025, ndërsa, konkursi është shpallur më datë 19.08.2025.

Rrjedhimisht, në kuptim të pretendimit ankimor se MPJD-ja nuk ka marrë parasysh opinionin ligjor të datës 31.01.2018 të Avokatit të Popullit, Kolegji i Këshillit në kontekst të përvojës profesionale sikurse në këtë rast, thekson faktin se përvojë pune profesionale konsiderohet vetëm përvoja pas diplomimit në studime themelore, përcaktim ky tashmë i konsoliduar më praktikën vendimmarrëse të Këshillit dhe i konfirmuar edhe nga gjykata (Aktgjykimet e Gjykatës Themelore A.nr.2276/2014 dhe A.nr.729/2016, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.nr.367/2018, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ARJ-AZVP nr.77/2019).

Andaj, duke u nisur nga fakti se ankuesi nuk ka arritur të argumentoj se posedon përvojë një vjeçare profesionale siç kërkohej më konkurs, Kolegji konstaton se nuk kanë mbështetje pretendimet ankimore të ankuesit dhe si rrjedhojë Njësia e Burimeve Njerëzore të MPJD-së më rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, duke vepruar në pajtim më dispozitat e nenit 39, paragrafi 7.1 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku parashihet se: *7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit.*

Duke qenë së pretendimet ankimore i referohet fazës së verifikimit paraprak, Kolegji ka trajtuar vetëm ligjshmërinë e akti të kontestuar, pasi që, Këshilli me Vendimin A.nr.1909/2025, të datës 25.05.2025, ka vendosur në tërësi lidhur me ligjshmërinë e procedurës se pranimit më numër reference: RN00018442.

Thënë si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.1942/2025

Merlinda Ramaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit E.H;*
- *MPJD: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të NJBNJ, dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*